



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR ECURINË E PROCESIT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E KUVENDIT¹, 28 QERSHOR 2009

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është organizata e parë joqeveritare e krijuar në Shqipëri. U themelua më 19 dhjetor të vitit 1990, si Forumi për Mbrojtjen e Lirive dhe të të Drejtave Themelore të Njeriut dhe është regjistruar me vendimin nr. 17/1 të Ministrisë së Drejtësisë. Më 22 mars 1992, organizata u anëtarësua në Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, duke marrë edhe emrin që ka sot. Pas miratimit të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”, KShH-ja u regjistrua pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të Tiranës.

Misioni kryesor i KShH-së është:

- *Vëzhgimi* i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.
- *Sensibilizimi* i opinionit publik për të drejtat politike, shoqërore, civile dhe kulturore, për mbrojtjen e tyre dhe për procedurat që duhet të ndiqen në rast se këto të drejta dhunohen.
- *Reagimi* nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, kontakteve të drejtpërdrejta ose raporteve drejtuar autoriteteteve përkatëse kundrejt shkeljeve të akteve ligjore, të brendshme dhe ndërkombëtare, që i përkasin kësaj sfare, për të vënë në vend të drejtat e dhunuara.
- *Përmirësimi* i legjislacionit dhe i praktikës për zbatimin e ligjit nëpërmjet oponencave dhe rekomandimeve, si në fazën e projektit, ashtu edhe gjatë zbatimit të tyre.
- *Reagimi* për rritjen e përgjegjshmërisë së administratës publike në zbatimin me korrektësi të ligjit dhe për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut.
- *Botimi* i raporteve për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri; i informacioneve në formë fletëpalosjesh, kartash ligjore, broshurash, guidash etj.; i buletineve dhe i raporteve tremujore në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.

¹ Botimi i këtij raporti është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasades së SH.B.A.-se në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- *Mirëmbajtja* e një databaze me materiale ligjore për të drejtat e njeriut si dhe të dhëna për shkeljet e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe në burgjet dhe komisariatet e policisë, në veçanti.

KShH-ja ka monitoruar pothuajse të gjitha proceset zgjedhore që janë zhvilluar në Shqipëri.

Në zgjedhjet e Kuvendit, më 28 qershor 2009, KShH-ja aktivizoi 150 vëzhgues afatgjatë të akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja). Ata u trajnuan në sesione trajnime të veçanta për aspekte të rëndësishme të Kodit zgjedhor dhe në mënyrë të veçantë për metodologjinë e vëzhgimit.

Objekt i këtij vëzhgimi ishin: ngritja dhe funksionimi i administrates zgjedhore, pajisja e qytetarëve me karta identiteti, shpallja e listave paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve, si dhe vëzhgimi i disa elementeve të fushatës elektorale, procesin e votimit dhe numërimit të votave.

KShH-ja **monitoroi rreth 700 qendra votimi në rrethet kryesore të vendit². U vëzhguan gjithashtu rreth 25 qendra të numërimit të votave në KZAZ të përfshira në zonat ku u shtri vëzhgimi.**

Falënderime

KShH-ja falënderon të gjithë vëzhguesit e tij dhe korrespondentët në 8 rrethet kryesore të vendit për profesionalizmin, paanshmërinë dhe përkushtimin e tyre.

Falënderon KQZ-në për akreditimin e vëzhguesve të KShH-së, për informimin dhe vënien në dispozicion të udhëzimeve dhe të informacioneve të nevojshme për vëzhgim.

KSHH falenderon gjithashtu Ambasadën Amerikane në Tiranë që na mundësoi nëpërmjet mbështetjes financiare kryerjen e vëzhgimeve të zgjedhjeve parlamentare, të 28 qershorit 2009.

² Qarkun në Tiranë (KZAZ-të 44 - 57), të Gjirokastrës, të Elbasanit, të Fierit, të Durrësit, të Shkodrës, të Vlorës, Kukësit dhe Korçës.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

1. Kuadri ligjor dhe reforma zgjedhore

KShH-ja është e mendimit se ecuria e procesit zgjedhor në përputhje me ligjin dhe sipas standardeve të kërkuara ndikojnë fuqimisht në ushtrimin e së drejtës së votes, konsolidimin e institucioneve demokratike dhe integrimin European të vendit tonë.

Në datën 14 Janar 2009 Presidenti i Republikës së Shqipërisë caktoi datën e zgjedhjeve parlamentare: 28 qershorin 2009. Kodi zgjedhor ndryshoi tërësisht dhe u miratua në 29 dhjetor 2008.

Ai u miratua me konsensusin e dy partive të mëdha politike edhe pse pati kontestime nga disa parti të vogla. KSHH mendon se do të ishte mirë që para miratimit të tij të ishte zhvilluar një diskutim dhe debat më i thelluar dhe gjithpërfshirës. Kjo në fakt mungoi.

Në fushën e reformës zgjedhore dhe në zhvillimin e zgjedhjeve janë bërë disa hapa pozitivë. Në këtë kuadër, mund të përmendim:

- a) për herë të parë, me ligj, u parashikuan disa masa të posaçme për të siguruar shanse të barabarta gjinore.
- b) U parashikua detyrimi ligjor për pajisjen me karta të identitetit të qytetarëve që nuk dispononin pashaporta, duke përjashtuar kështu certifikatat që mund të linin shkas për manipulime.
- c) Sistemi elektoral proporcional rajonal, i sanksionuar në Kushtetutë dhe në Kodin zgjedhor mendojmë se ndihmoi në përjashtimin e të ashtuquajturit fenomen i “dushkut”, që shtrëmbëronte vullnetin e zgjedhësve, megjithëse në këtë drejtim pati dhe vërejtje.
- d) Procesi i numërimit të votave u fiksua dhe u transmetua nëpërmjet kamerave elektronike.

2- Kartat e identitetit

Sipas nenit 179 të Kodit zgjedhor, në zgjedhjet e 28 qershorit 2009 do të votohej vetëm me pasaportë për jashtë shtetit ose me karta identiteti. Këshilli i Ministrave ngarkohej të nxirrte aktet përkatëse nënligjore për pajisjen me përparësi me karta identiteti të zgjedhësve që nuk dispononin pasaporta të vlefshme për jashtë shtetit. Po në këtë dispozitë Ministria e Brendshme ngarkohej të informonte për ecurinë e këtij procesi KQZ-në në mënyrë periodike por jo më vonë se një herë në muaj.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Vlen të përmendet se OSBE/ODIHR-i që në vitin 2005 rekomandonte që në rast se qeveria dëshironte të pajiste shtetasit me karta identiteti duhet që për këtë paraprakisht të organizoheshin konsultat përkatëse (shih raportin e OSBE/ODHIR-it, nëntor 2005, faqe 35, rekomandimi nr. 19). Siç duket, ky rekomandim nuk u mbajt parasysh. Sipas njoftimit zyrtar të Ministrisë së Brendshme, rreth 250 mijë zgjedhës që nuk dispononin pasaporta, nuk aplikuan dhe si rrjedhim nuk u pajisën me karta identiteti. Pavarësisht nga shkaqet që ndikuan negativisht në realizimin e kësaj kërkesë ligjore (për këtë bëhet fjalë edhe në raportet e ndërmjetshme të vëzhguesve ndërkombëtarë), KSHH mendon se fakti i mësipërm ka cënuar një nga parimet që ka të bëjë me të drejtën e ushtrimit të votës. Pikërisht për këtë arsye KSHH ka reaguuar publikisht dy herë duke u bërë thirrje zgjedhësve që të pajisen me këto karta dhe administratës zgjedhore që ta mundësonte realizimin e këtij standarti³.

3- Administrata zgjedhore

KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të u ngritën me vonesë, sepse propozimet e partive politike përkatëse u paraqitën me vonesë, megjithëse KQZ ndërhyri disa herë. Negative ishte se edhe mbas miratimit të tyre nga KQZ-ja dhe KZAZ-të, herë pas herë kërkohej zëvendësimi i tyre me të tjerë. Vëzhgimet tona konstatuan se KZAZ-të edhe mbas ngritjes nuk funksionuan në mënyrë normale. Shpesh lokalet ku ato ishin vendosur qëndronin të mbyllura.

KZAZ-të nuk aritën të verifikonin siç duhej kushtet dhe kriteret që sipas Kodit zgjedhor duhet të përmbushnin anëtarët dhe sekretari i KQV-ve. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për GNV-të.

Vëzhguesit e KSHH-së konstatuan gjithashtu se trajnimi i tyre për arsyet e përmendura sa më lart nuk ishte cilësor, madje pjesërisht ai ishte formal ose nuk u krye. Në disa raste trajnimi i anëtarëve të GNV-ve u bë në orën ose në kohën kur duhet të fillonte numërimi i votave.

4 – Listat shumëemërore të kandidatëve

Listat shumëemërore të kandidatëve u paraqitën ditën ose orën e fundit që KQZ-ja duhet ti miratonte. Për mungesat që ato kishin, KQZ-ja me të drejtë disa prej tyre i ktheu për korrigjim.

³ Deklarata e KSHH-së, datë 9 shkurt 2009



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Sipas pikës 5 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor për çdo zonë zgjedhore të paktën 30% të listës shumëemërore dhe /ose një në tre emrat e parë të listës shumëemërore duhet ti përkiste secilës gjini. Dispozita e mësipërme nuk u zbatua me rigorozitet madje gratë u rrjeshtuan në atë mënyrë sa dihej që në fillim se nuk do të fitonin ose për të qënë në rregull (formalisht) me këtë përqindje u bënë shtesa tej numrit të kandidatëve për çdo zonë.

Në datën 1 gusht 2009, KQZ-ja shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Duke u njohur me listat shumëemërore rezulton se për LSI-në, PBDNJ-në, PDI-në dhe PR-në nuk kishte fituar asnjë kandidatë femër. PD-ja nga 68 mandate kishte 10 femra fituese ose 14.7%, ndërsa PS-ja nga 65 mandatet kishte 12 femra fituese ose 18.4%. Parlamenti prej 140 deputetësh do të ketë vetëm 22 femra ose 16% të të gjithë deputetëve.

Një çështje tjetër që u bë objekt diskutimi në mbledhjen e KQZ-së ishte dhe qëndrimi që duhet të mbante KQZ-ja lidhur me rastet kur në listat shumëemrore ishin përfshirë edhe kandidatë që sipas nenit 69 të Kushtetutës duhet që më parë të largoheshin nga detyrat që kishin.

Fillimisht u tha se KQZ nuk kishte ndonjë detyrim ligjor për ta shqyrtuar këtë çështje, ndërsa më vonë kur listat shumëemërore ishin miratuar, u pranua se kjo përbënte shkelje, por riskun e së cilës le ta mbanin vetë partitë politike, ndërsa KQZ-ja mund t'u bënte atyre vetëm një njoftim edhe pse dihej se ky njoftim i vonuar nuk do të kishte ndonjë efekt. Sipas Kodit zgjedhor, listat pas miratimit nuk mund të ndryshonin. Veç kësaj, largimi nga detyra duhej bërë para miratimit të listave, në të kundërtën mandati i fituar në kundësttim me nenin 69 të Kushtetutës konsiderohet i pavlefshëm (pika 2 e nenit 69 të Kushtetutës).

KSHH mendon se KQZ-ja duhet ta shqyrtonte këtë çështje dhe të mos miratonte kandidatin që nuk kishte dhënë efektivisht dorëheqjen. KQZ-ja duhet të zbatonte pra nenin 69 të Kushtetutës.

KSHH mendon gjithashtu se, KQZ-ja duhet të kishte parasysh dhe të zbatonte ato që thuhet në pikën 3 të nenit 63 të Kodit Zgjedhor, se kandidat është shtetas që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës. Si rrjedhim kandidati që nuk plotësonte kushtet e parashikuara në dispozitat e mësipërme kushtetuese nuk duhet të përfshihej në listat shumëemërore.

5. Listat e zgjedhësve



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Shpallja e listave paraprake dhe përfundimtare

Vonesat në shpalljen e listave varonin me disa ditë. Vlen të përmendet se, në disa qendra votimi nuk u respektua neni 54 i Kodit Zgjedhor, i cili detyron që listat përfundimtare të zgjedhësve të shpallen “...në një vend publik me hyrje të lirë...”. Si rrjedhim për shkak të vonesës dhe të mosrespektimit të nenit të mësipërm u reduktua koha e njohjes së zgjedhësve me to. Veç kësaj sensibilizimi i zgjedhësve për t’u njohur me këto lista ishte relativisht i pakët. Në 14 maj 2009, KQZ-ja mori masa gjobitje ndaj 59 kryetarëve të Bashkive dhe komunave për mosparaqitjen në afatin e përcaktuar të listave paraprake të zgjedhësve.

Ndërkohë, në disa qendra të tjera votimi rezultuan fletë të grisura nga listat e publikuara gjë që dëshmon se ato nuk janë vendosur në mjedise të mbrojtura. Një problem tjetër që u konstatua ishte vendosja e listave në lokale private ku kufizohej aksesit i zgjedhësve për t’u njohur me to.

Vëzhguesit e KShH-së konstatuan gjithashtu se neni 50 i Kodit Zgjedhor u zbatua vetëm pjesërisht. Disa verifikime që u bënë në vend vërtetuan se zgjedhësit nuk ishin njoftuar me shkrim për numrin e qendrës së votimit dhe për listën e shpallur. Por kishte dhe raste të tjera që nuk rezultonte që njoftimi të ishte shoqëruar me firmosjen personale të tyre.

Edukimi ligjor i votueve dhe sensibilizimi i tyre ishte relativisht i ulët. Spotet televizive për edukimin zgjedhor të shtetasve të inicuar nga KQZ-ja, mendojmë se kanë qënë të pamjaftueshme dhe disi të vonuar.

Kërkesë – ankesat drejtuar kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe gjykatave

Sipas një informacioni të pjesshëm, numri i zgjedhësve drejtuar njësisë të qeverisjes vendore për korrigjimin e listave ishte i pakët. Në gjykatat e rretheve rezultoi se ishin bërë kërkesë-ankesa për ushtrimin e së drejtës së votës nga qytetarët të cilët nuk gjenin emrin e tyre në listë. Sipas të dhënave nga vëzhguesit tanë ka rezultuar se deri në datën 26 qershor 2009, në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, ishin paraqitur 430 kërkesa. Gjithashtu dhe në disa qytete të tjera ka pasur kërkesa pranë gjykatës, por në numër më të pakët.

Shkaqet e kësaj gjendjeje mund të jenë nga më të ndryshmet. Por, shqetësues mbetet fakti që, edhe pse u krijua regjistri elektronik kemi mendimin se duke përqëndruar vëmendjen tek pajisja e shtetasve me karta identiteti, problemit të saktësisë të listave të zgjedhësve nuk ju kushtua kujdesi i duhur.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

6. Fushata zgjedhore

Situata e përgjithshme

Megjithëse zyrtarisht fushata zgjedhore duhet të fillonte në 28 Maj 2009 dmth një muaj para zgjedhjeve, ajo praktikisht ka filluar qysh në muajin Shkurt 2009. Skena politike u shfaq tepër e polarizuar midis partive politike PD dhe PS⁴.

Është e vërtetë se Kodi Zgjedhor nuk e ndalon një gjë të tillë, por duke ndjekur disa nga takimet, mitingjet dhe përdorimin e mjetet propogandistike, krijohet përshtypja se shpenzimet për fushatën kanë qenë të mëdha. Në të njëjtën kohë ka munguar dhe transparenca lidhur me burimin e këtyre të ardhurave. Është e vërtetë se në Kodin e ri u bënë disa ndryshime lidhur me këtë çështje, por mekanizimi i kontrollit lë për të dëshiruar.

Propaganda elektorale edhe pse shënoi një hap përpara në shpalosjen e alternativave, duket se një numër i konsiderueshëm premtimesh vështirë të realizohen. Në disa takime u vu re përdorimi i gjuhës së urrejtjes. Gjatë fushatës sidomos muajin e fundit u vërtetuan dhe disa incidente të provokuara nga militantë partiakë. Në disa raste vëzhguesit e KShH-së kanë raportuar se administrata publike dhe shkollat janë përdorur për qëllime elektorale. Ka patur gjithashtu ankesa që nuk mundëm ti verifikonim se mbi punonjësit e administratës publike është përdorur presion për të votuar në favor të kandidatëve të partisë në pushtet.

Gjatë fushatës elektorale, në një masë të paparë ndonjëherë u përdorën postera të ndryshme si dhe mjete të tjera propogandistike. Organet e qeverisjes vendore kanë qenë të vonuara në përcaktimin e vendeve se ku do të vendoseshin ato. Ka patur grisje të flamurëve të partive përkatëse, si dhe heqje të posterave duke u bërë shkak për incidente mes simpatizantëve të forcave politike.

7. Policia e Shtetit

KShH-ja vlerëson rolin e policisë para dhe gjatë ditës së votimit, në transferimin e kutive të votimit për në qendrat e numërit të votave dhe gjatë procesit të numërimit të votave.

⁴ Shih raportin e ndërmjetër Nr. 1 të OSBE/ODIHR, datë 26 Maj 2009



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ajo ka ndërhyrë vetëm në bazë të vendimeve të marra nga komisionet zgjedhore. Në vendet e vëzhguara nga KShH-ja nuk u vërejtën raste njëanshmërie ose ndërhyrjesh arbitrare nga ana e Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit në bashkëpunim me KQZ-në kanë trajnuar oficerët e policisë lidhur me veprimet dhe kompetencat e tyre gjatë zgjedhjeve parlamentare 2009.

8. PROCESI I VOTIMIT

- ***Komisionet e qendrave të votimit dhe hapja në kohë e qendrës së votimit***

Vëzhguesit e KSHH-së asistuan në përgatitjet për fillimin e procesit të votimit në rreth 700 QV në qarqet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Elbasanit, Fierit, Gjirokastrës, Korçës, Vlorës, Kukësit. Jo të gjithë anëtarët e KQV-së dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë qenë të pranishëm në orën e caktuar për fillimin e përgatitjeve paraprake për votim. Kjo është hasur në shumë qendra votimi në të gjitha rrethet, kryesisht në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Kukës, Gjirokastrë, Elbasan, Fier dhe Korçë. Vonesat e disa komisionerëve kryesisht të partive të vogla bënë që të kishte vonesa në fillimin e procesit të votimit. Arsye të tjera të fillimit me vonesë të procesit të votimit ishin: mbërritja e bazës materiale me vonesë, sidomos të bojës për vulën, ose për shkak të faktit se, anëtarët e KQV-së, si dhe disa vëzhgues të subjekteve zgjedhore jo të gjithë kanë qenë të pranishëm në orën e caktuar për fillimin e përgatitjeve për votim, etj.

Shqetësues ka qënë fakti se, gjatë ditës së votimit, ka vazhduar ndërrimi i komisionerëve nga subjektet politike, duke shkaktuar vonesa dhe pezullim të procesit të votimit (*rast flagrant QV Kukës 0652 në orën 16:00*). Ka pasur ndonjë rast kur votimi është pezulluar për pak orë duke rifilluar më pas në mënyrë të qetë (Vlorë, Kukës). Mosardhja e autorizimeve të miratimit të tyre, ndërrimi i tyre i herëpashershëm, ardhja me vonesë në qendrën e votimit të komisionerëve, ka sjellë vonesa në fillimin e votimit.

Vëzhguesit e KShH-së vunë re se pranë disa qendrave votimi deri në largësinë prej 150 metrash kishte pasur materiale propagandistike, postera të kandidatëve dhe të partive, të cilat, pas vërejtjeve të vëzhguesve të KShH-së, në disa raste u hoqën, ndërsa ka pasur edhe raste kur nuk janë hequr, si p.sh., në Tiranë, Vlorë, Korçë, Shkodër, Durrës, etj.

Në shumicën e qendrave të votimit të vëzhguara nga KSHH, procesi i votimit ka qënë i qetë dhe pa incidente. Në disa qendra ka patur mosmarrëveshje midis komisionerëve. Në këto raste binin në sy qëndrimet e tyre të politizuara në mbrojtje të subjekteve përkatëse.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

▪ *Disa zgjedhës nuk patën mundësi të votojnë*

Në disa qendra votimi kishte persona të cilët nuk mundën të votonin për arsye se emri i tyre nuk figuronte në listat e zgjedhësve. Gjithashtu, kishte pasaktësi në regjistrimin e emrit ose mbiemrit, sidomos në Tiranë, Kukës, Vlorë, Durrës, Elbasan, Korçë, Institucioni i paraburgimit Peqin dhe Institucioni i paraburgimit Durrës. Ka pasur edhe ndonjë rast mospërputhjeje të emrave në listat e shpallura përfundimtare në ambientet e qendrave të votimit, me ato që dispononin KQV-të përkatëse. Një problem që u vu re ishte se, në disa QV nuk janë lejuar të votojnë zgjedhëset gra, të cilave në pasaporta u figuronte mbiemri i vajzërisë dhe në listat e zgjedhësve kishin mbiemrin e bashkëshortit. KSHH sinjalizoi për këtë edhe KQZ-në.

Nuk patën mundësi të votojnë dhe disa zgjedhës të cilët ishin të pajisur me vendim gjykate me arsyetimin se në to nuk ishte shënuar numri i dokumentit të identifikimit të përsosur, ose vendimi ishte i pavulusur. Kjo u vu re në Tiranë, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë.

Votimi i personave të paraburgosur, të dënuar dhe ushtarakët. Të paraburgosurit dhe të dënuarit votuan në qendrat e votimit të posaçme të ngritura pranë institucioneve ku vuajnë dënimin ose qëndrojnë të paraburgosur. Nga verifikimet që u bënë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, si dhe nga vëzhgimi i ditës së votimit në këto qendra votimi, rezultoi se një pjesë e mirë e këtyre personave kanë votuar me vendim gjykate, pasi nuk e kishin emrin në listën përfundimtare. Në Institucionin e vuajtjes së dënimit Ali Demi (325) nuk janë lejuar të votojnë rreth 60 të dënuar për shkak se në vendimin e gjykatës nuk përcaktohej numri i dokumentit të identifikimit të personave përkatës. Për këtë është vënë në dijeni edhe KZAZ-ja përkatëse por përgjigjia e saj ishte: nuk disponojmë fletë votimi të tjera veç atyre që u janë dërguar. Në fakt ato janë privuar (jo për fajin e tyre) nga e drejta e votës.

Ndalimi i votimit dy herë

Siguria në zgjedhje dhe përdorimi i bojës matrikuluese. Sipas nenit 105, gërma “dh” të Kodit Zgjedhor, zgjedhësi timbroset në dorën e majtë me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një herë. Verifikimi se mos zgjedhësit kanë qënë të timbrosur më përpara është bërë rregullisht. Gjithashtu dhe timbrojsja e gishtave është bërë rregullisht në qendrat e votimit. Sipas disa provave që u bënë, boja nuk ishte cilësore, sepse lehtësisht ajo mund të hiqej.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Sipas legjislacionit zgjedhor, zgjedhësi duhet të firmosë përbri emrit të tij si dhe duhet ti hiqet vizë emrit të tij, procedura të cilat janë respektuar pothuajse në qendrat e votimit të vëzhguara nga KSHH.

Votimi familjar

Në këto zgjedhje janë evidetuar disa raste të votimit familjar ose në grup duke cënuar kështu parimin themelor të fshehtësisë së votës. Nga vëzhguesit tanë, ky fenomen u vu re në disa qendra votimi në Durrës, Shkodër, Korçë, Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Kukës. Për këtë, vëzhguesit e KSHH-së kanë paraqitur në komisionet e qendrave të votimit të vëzhguara edhe vërejtjet me shkrim. Ky fenomen i dëmshëm, u tolerua nga vetë KQV-të. E keqja është se e njëjta gjë, ka ndodhur edhe në zgjedhjet e mëparshme.

Votimi i personave me aftësi të kufizuar ose në pamundësi për të votuar

Sipas nenit 108 i Kodi zgjedhor, kur një person për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Në këtë drejtim, vëzhguesit e KSHH-së nuk raportuan shkelje të ligjit.

Në datën 17 Maj 2009, media njoftonte se 9500 të verbër kishin njoftuar KQZ-në që për ta të përgatiteshin fletë votimi të veçanta për të ruajtur fshehtësinë e votës.

Në vendimin Nr. 272 të KQZ-së, u miratua përdorimi i mjetit të posaçëm të votimit që do të mundësonte zgjedhësit e verbër për të lexuar fletën e votimit por ky udhëzim shtrihej vetëm për Tiranën. Nga vëzhgimi rezultoi se në disa qendra votimi në Tiranë nuk kishte pajisje të posaçme për leximin e fletës së votimi nga të verbërit. Personat me aftësi të kufizuar jo në të gjitha QV kishin mjetet e nevojshme lëvizëse megjithëse në vendimin Nr. 343, datë 12.06.2009 të KQZ-së, miratohej përdorimi i pajisjeve ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë të personave me aftësi të kufizuar në mjediset e qendrave të votimit.

Mbyllja e votimit

Mbyllja e votimit. Procedurat për mbylljen e qendrave të votimit përfunduan pa probleme. Në pjesën më të madhe të tyre, votimi u mbyll brenda orës 19:00. Ka pasur edhe disa qendra votimi, që janë mbyllur me 30 - 60 min vonesë. Vetëm në një rast (për shkak të pezullimit të votimit për



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

disa orë) procesi ka përfunduar deri në 2 orë me vonesë (Kukës). Kutitë e votimit dhe kutia me materialet e votimit janë futur në makinë dhe janë shoqëruar për në qendrën e votimit qetësisht dhe pa incidente. Probleme janë shfaqur në vonesën e mbërritjes së automjeteve në Qv për transportimin e kutive të votimit dhe me materialet e votimit.

Transportimi i kutive të votimit. Sipas ligjit, kutitë e votimit duhet të mbërrinin brenda 3 orëve në vendin e numërimit të votave. Në një pjesë të madhe të vendeve të numërimit, kutitë e votimit kanë mbërritur në kohë. Probleme janë shfaqur në ato QV, të cilët i përkasin komunave që ndodheshin larg qendrave ku do të bëhej numërimi.

9. PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

Në Kodin zgjedhor me dispozitë të veçantë në mënyrë të detajuar është parashikuar procedura që duhet të ndiqet gjatë numërimit të votave (Neni 110). Vëmendje, ligjëbërësi i ka kushtuar problemit të kriterëve për vlerësimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme (neni 117), nxjerrjes të rezultatit të zgjedhjeve nga grupet e numërimit (neni 119), si dhe plotësimit të nxjerrjes së tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ-ja (neni 122).

Megjithëse për kontestimet ai që vendos (sipas Kodit) është KZAZ-ja, zbatimi i dispozitave të mësipërme, kërkonte njohuri të mjaftueshme ligjore nga anëtarët e grupeve të numërimit, por siç u përmend edhe më lart, për shkak të trajnimit të shpejtë, madje dhe formal, anëtarët e këtyre grupeve u paraqitën me boshllëqe të theksuara në një proces kaq të rëndësishëm siç është ai i numërimit të votave..

Kjo u konstatua gati në të gjitha GNV-të e vëzhguara. Ato e filluan punën me vonesë ose më shumë vonesë. Në KZAZ-të Nr. 8 dhe 25, numërimi i votave filloi në ora 4 ose 5 të mëngjesit të datës 29 qershor 2009. Asnjë nga GNV-të nuk përfundoi procesin e numërimit brenda orës 17:00 të datës 29 qershor siç parashikon kodi.

Gjatë monitorimit në KZAZ-të nr. 20, 41, 50, 51, 57 sistemi i kamerave nuk funksionoi në rregull. U vërtetuan ngadalësime dhe ndërprerje. Për vëzhguesit, në disa raste ka qënë e pamundur ndjekja e këtij procesi në momentin e vlerësimit të votës dhe vendosjes së tyre në stivat përkatëse. Nuk kanë munguar edhe kontestimet e paraqitura nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore lidhur me vlefshmërinë ose jo të fletëve të votimit. Ndërhyrjet partiake kanë qënë të theksuara gjë që ndikoni negativisht jo vetëm në grupet e numërimit të votave, por edhe në KZAZ-të. Për shkak të mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të GNV-ve u vërtetuan ndërprerje të këtij procesi deri në bllokimin e përkohshëm të tij. Në vendet e numërimit në Korçë, Fier, Tiranë, Gjirokastrë, Vlorë



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

dhe Paskuaqan ka patur ndërprerje edhe në ditët e mëvonshme). Për këtë arsye KSHH ka reaguuar dy herë publikisht. Në këto deklarata, veç të tjerave, sugjerohej ndërhyrja e KQZ-së⁵.

Vëzhgimi i KSHH-së u kufizua vetëm në datën 29 qershor, pavarësisht se ky proces vazhdoi edhe më tej. Kjo u kushtëzua nga mundësitë që ai kishte.

Duke u njohur me raportet ndërmjetëse të vëzhguesve ndërkombëtare, që e ndoqën deri në fund procesin e numërimit të votave, në mënyrë të detajuar, paraqiten disa shkelje të rëndësishme dhe shqetësuese, që e bënë problematik këtë proces.

10. Monitorimi pjesërisht i veprimtarisë së KQZ-së

KSHH vlerëson rolin e KQZ-së si organi më i lartë i përhershëm shtetëror, i ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve. KQZ ka marrë të gjitha masat e mundshme dhe të nevojshme tekniko – organizative për mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Ai ka hasur në disa vështirësi për shkak se partitë politike (subjektet zgjedhore) nuk zbatonin afatet e caktuara nga Kodi Zgjedhor dhe propozonin ndryshime të shpeshta në përbërjen e komisioneve zgjedhore.

KQZ ka miratuar një seri udhëzimesh në ndihmë të komisioneve më të ulta zgjedhore. Por në veprimtarinë e këtij komisioni konstatojmë edhe disa boshllëqe dhe të meta si edhe qëndrime që nuk pajtohen me rolin dhe funksionin e tij si organ i paanshëm që zbaton me rigorozitet vetëm ligjin.

- a. KSHH- ka reaguuar publikisht dhe i ka sugjeruar KQZ-së të jetë objektiv dhe i paanshëm, mos nxitohej në shpallje e rezultateve të zgjedhjeve⁶.
- b. KSHH i ka sugjeruar KQZ-së që të zbatonte kërkesën e pikës 3 të nenit 73 të Kodit zgjedhor që e ngarkonte atë të publikonte listën e plotë të kandidatëve në tri gazetatat me tirazh më të madh në shkallë vendi, por ky sugjerim nuk u morr parasysh. Ishte e drejtë e zgjedhësve të njiheshin me këto lista.
- c. Ndërhyrjet ose deklaratat e anëtarëve të KQZ-së, sidomos të kryetarit të tij, mendojmë se: në disa raste ishin jo profesionale por të politizuara gjë që binte ndesh me funksionin që atyre u ka ngarkuar ligji. Votimi për disa çështje nga më të rëndësishmet dhe më delikatet, (4 pro 3 kundra), krijoi përshtypjen e bazuar se zbatoheshin qëndrime të natyrës partiake të mazhorancës dhe opozitës.
- d. KSHH e konsideron shkelje të rëndë të ligjit refuzimin nga ana e shumicës në KQZ të kërkesave të dy anëtarëve të saj për të marrë prova të reja ose për rinumërimin dhe/ose

⁵ Shih deklaratat 2 dhe 4 korrik 2009

⁶ Deklarata, datë 4 korrik 2009



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

rivlerësimin e votave të caktuara (përkatësisht sipas nenit 136 pika 3 dhe nenit 138 pika 3 të Kodit Zgjedhor). Në zbatim të dispozitave të mësipërme KQZ-ja është e detyruar të miratojë kërkesën e dy anëtarëve të KQZ-së. Në këto nene përmenden përkatësisht shprehjet se KQZ ...“është e detyruar të marrë provat e kërkuara”... se KQZ ...“është e detyruar të bëjë runimërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të kërkuara”. Në ligj nuk thuhet se bazueshmëria e këtyre kërkesave çmohet apo vlerësohet nga KQZ-ja.

- e. KSHH mendon se kasetat ose filmimet elektronike që u përdorën për fiksimin e procesit të numërimit të votave përbëjnë prova ose shërbejnë si të dhëna për marrjen dhe verifikimin e provave. Mendimi i shprehur në KQZ, se ato nuk janë prova mendojmë se nuk përputhet me nenin 136 pika 1 gërma “b” të Kodit Zgjedhor. Llojet e provave që administron KQZ-ja parashikohen në Kodin e Procedurës Civile⁷. Veç kësaj vetë fakti se për këtë flitet edhe në pikën 4 të nenit 94 (përdorimi i kamerave rregjistruese) konfirmon qënien e tyre si provë. Po në këtë dispozitë thuhet se KQZ-ja është e detyruar të riprodhojë kopjet e tyre dhe ti vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore. Kjo do të thotë se në bazë të kqyrjes apo shikimit të tyre, ata kanë të drejtë të paraqesin pretendimet përkatëse.
- f. E shikojmë të nevojshme të përmëdim gjithashtu se KSHH nuk është pajtuar me qëndrimin e kryetarit të KQZ-së që i kishte kërkuar Ambasadores Glover të tërhiqej nga misioni i saj kryesues i grupit vëzhgues të ODIHR-it. Lidhur me këtë çështje, KSHH ka reaguar nëpërmjet një deklarate ku veç të tjerave thuhet se: ...”KSHH i sugjeron Z.Ristani, Kryetari i KQZ-së, që të jetë më i rezervuar dhe më i matur në prononcimet e tij publike dhe të mos vihet në rolin e “arbitrit” ose të një “ndërmjetësi ekuilibruës”. Besimin e palëve (subjekteve zgjedhore) në procesin zgjedhor e garantojnë dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor. Për KShH-në ishte dhe është i pakonceptueshëm një qëndrim i tillë kur dihet se edhe vetë KQZ-ja do të ishte nën monitorimin e vëzhguesve ndërkombëtarë, sidomos të OSBE/ODIHR-it.

I përmëdëm këto çështje sepse veprimtaria pozitive ose negative e KQZ-së, respektimi ose jo me rigorozitetin e dispozitave të Kodit Zgjedhor ndikon pozitivisht apo negativisht në aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor.

11. Lidhur me standartet e zgjedhjeve

Edhe pse vëzhgimi i zgjedhjeve të 28 qershorit nga KShH-ja, siç u përmend edhe më lart, ishte i pjesshëm, disa nga shkeljet e konstatuara, mendojmë se e kanë dëmtuar procesin zgjedhor, pikërisht

⁷ Shih Nenet 278 dhe 279 të Kodit të Procedurës Civile ku bëhet fjalë për filmat, fotografitë dhe kasetat



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

në ato elementë që në mënyrë direkte apo indirekte, kanë të bëjnë me arritjen e standarteve që kërkohen.

Nëse do t'i referoheshim raporteve të ndërmjetme të vëzhguesve ndërkombëtarë, krahas disa arritjeve, në drejtim të kuadrit ligjor dhe të përgatitjeve paraprake tekniko-organizative, paraqiten të dhëna dhe fakte shqetësuese, qëndrime të njëanshme dhe të politizuara të KQZ-së, presione dhe ndërhyrje në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore, vlerësime negative sidomos gjatë fazës së numërimit të votave etj⁸. Në këtë vështrim, me keqaradhe mund të thuhet se edhe në këto zgjedhje nuk u arritën standartet e sanksionuara në kartën e Kombeve të Bashkuara, dokumentet ndërkombëtare të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990, të KE-së dhe të BE-së, të parimeve që përmban Kodi i Praktikës së Zgjedhjeve i miratuar në vitin 2002 nga Komisioni i Venecias.

Dihet se çertifikimi përfundimtar i zgjedhjeve të 28 qershorit 2009, do të bëhet në raportin përfundimtar të OSBE-ODIHR-it. Konstatimet, vlerësimet dhe rekomandimet që do të paraqiten në këtë raport do t'u shërbejnë të gjithëve: aktorëve dhe faktorëve në këtë proces, përfshirë këtu edhe KQZ-në si organin më të lartë shtetëror të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve.

KShH në këtë fushë, edhe në të ardhmen, do të japë kontributin e tij modest.

⁸ Shih raportin e ndërmjetshëm datë 10 korrik 2009 që përfshin periudhën pas zgjedhore, 29 qershor – 7 korrik 2009



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ANEKS 1

DEKLARATAT E KSHH-SË

1. PAISJA E SHTETASVE ME KARTA IDENTITETI, PROCES I VËSHTIRË, POR E MUNDSHME

Tiranë, 9 shkurt 2009

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) vlerëson se paisja me karta identiteti të shtetasve që nuk kanë pashaportë është faktor më rëndësi për realizimin e së drejtës për të votuar dhe për një pjesëmarrje sa më të gjerë të votuesve në zgjedhjet parlamentare të 28 Qershorit 2009.

KSHH-ja vlerëson se do të ishte një shkelje e rëndë e së drejtës për të votuar nëse shtetasit nuk arrijnë të paisen me karta identiteti, për shkak të dobësive teknike, organizative, elementëve euforikë të pabazuar dhe mosnjoftimit në kohë të shtetasve.

KSHH po ndjek me vëmendje këtë çështje në Tiranë dhe në disa bashki të tjera. E verteta është se ka vonesa të karakterit burokratik që kërkojnë ndërhyrje urgjente. KSHH konsideron shqetësues jo thjeshtë prodhimin në kohë të kartave të identitetit, por sidomos procesin e shpërndarjes së tyre dhe njoftimin e shtetasve që nuk disponojnë pashaporta, kur dihet se rreth 730 mijë shtetas duhet të paisen me këto karta.

Duke patur parasysh kohën relativisht të shkurtër që na ndan nga dita e zgjedhjeve, numrin e madh të shtetasve pa pashaporta në bashki dhe komuna të ndryshme, duke mbajtur parasysh faktin se sensibilizimi i publikut është i dobët, KSHH-a sugjeron:

1. Në çdo bashki dhe komunë **të bëhen publike emrat e personave që duhet të paisen me karta identiteti, afatet e fillimit dhe të mbarimit të këtij procesi.**
2. Të merren masa **për njoftimin individual të çdo shtetasi që nuk disponon pashaportë.** Këto masa duhet të jenë të shpejta, të kontrollueshme dhe të dokumentuara.
3. Është e nevojshme **të bëhet e qartë se në zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, do të votohet vetëm me pasaporta të vlefshme ose me karta identiteti dhe jo me letër njoftim të viteve të kaluara.** Ky problem është shqetësues për moshën e tretë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

4. Duke vlerësuar nevojën e respektimit të të drejtave të minoriteteve në ushtrimin e së drejtës së zgjedhjes, **KSHH i sugjeron Qeverisë shqiptare të vlerësojë mundësinë e paisjes me kartë identitetit falas të votuesve Rome dhe Egjyptianë, sidomos të atyre shtetasve që jetojnë me asistencë sociale.**
5. Duke mbajtur parasysh faktin se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, sidomos në komuna jeton në minimumin jetik ose ka familje me numër të madh anëtarësh me të drejtë vote, **KSHH-ja i sygjeron qeverisë shqiptare të paisë me karta falas shtetasit që jetojnë me asistencë sociale ose nën minimumin jetik.**
6. KSHH-ja sugjeron që strukturat përkatëse të lehtësojmë paisjen me kartë të shtetasve me aftësi të kufizuar, të personave të sëmurë, sidomos në rastet kur zyrat dhe ndërtesat ku janë vendosur zyrat e paisjes me kartë nuk janë të paisura me lehtësirat që mundësojnë lëvizjen e tyre. Gjithashtu është e nevojshme të merren masa organizative që të minimizohet sa të jetë e mundur koha e qëndrimit në zyra të personaev të sëmurë ose të moshës së tretë.
7. Duke patur parasysh se sipas nenit 105 të Kodit zgjedhor, në zgjedhjet e 28 qershorit 2009 do të votohet vetëm me karta identiteti dhe pashaportë, i sygjerojmë **KQZ-së që në mbështetje të nenit 21, pika 1 të Kodit zgjedhor të udhëzojë se me çfarë dokumenti do të votojnë shtetasit që vuajnë dënimin me burgim dhe personat e paraburgosur.**
8. KSHH-ja vlerëson rolin e medias së shkuar dhe elektronike, kombëtare dhe lokale dhe të gjithë mjeteve të tjera të informimit. **KSHH-ja nxit median që të fillojë sensibilizimin më të gjerë të publikut për nevojën e paisjes së shtetasve me karta identiteti.**
9. KSHH nxit të gjitha organizatat jofitimprurëse sidomos ato që veprojnë në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të shtetasve që të ndërmarrin veprimtari sensibilizuese me grupet që punojnë për paisen e tyre me karta identiteti.

2.NJË HAP I NXITUAR DHE ME PASOJA TË DËMSHME

Tiranë, më 13 maj 2009



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Sipas njoftimeve të medias së shkruar dhe asaj elektronike, qeveria shqiptare ka kërkuar largimin e drejtueses së misionit vëzhgues të ODIHR-it që ka ardhur në vendin tonë, me “arsyetimin” se ajo ka udhëhequr këtë mision në zgjedhjet parlamentare të vitit 1996.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) shpreh keqardhjen e tij për këtë hap të nxituar, të pajustificuar dhe të papranueshëm. Edhe pse nga ajo kohë kanë kaluar 13 vjet, vazhdojnë rezervat dhe kundërshtitë për atë që objektivisht ka ndodhur: manipulimet në zgjedhjet e 1996 janë konfirmuar jo vetëm nga ODIHR-i, por edhe nga grupe të tjera vëzhguesish të organizmave kombëtare dhe ndërkombëtarë. Madje, siç dihet, vërejtje për cënim të standarteve të kërkuara, janë vërtetuar edhe në zgjedhjet e mëpasshme, kryesisht për mungesë të vullnetit politik. Është kjo një nga arsytet që zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit të këtij viti konsiderohen si test i rëndësishëm për integrimin e vendit tonë në BE.

KSHH mendon se kërkesa e qeverisë për largimin e znj Glover, ambasadores, qoftë edhe në mënyrë indirekte, krijon hije dyshimi lidhur me deklaratat solemne dhe të përsëritura në drejtim të garantimit të zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të pakontestuar në 28 qershor 2009.

ODIHR-i, siç dihet, është institucion i specializuar në fushën e monitorimit të zgjedhjeve. Atë e ka karakterizuar integriteti dhe objektiviteti në monitorim, në përfundimet dhe rekomandimet e paraqitura në raportet përkatëse.

Shteti Shqiptar si anëtar i OSBE-së, ndër të tjerash, është i detyruar të zbatojë pikën 8 të dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 ku thuhet: “Shtetet pjesëmarrëse çmojnë se prania e vëzhguesve të huaj dhe të vendit i shërben përmirësimit të zhvillimit të zgjedhjeve në shtetet ku ato bëhen. Si rrjedhim ato ftojnë vëzhgues të çdo shteti tjetër që merr pjesë në OSBE”.

KSHH mendon se ftesa për vëzhgimin e zgjedhjeve, nuk mund të kushtëzohet me të drejtën e palës pritëse për të kërkuar seleksionim në përbërjen e misionit vëzhgues, aq më tepër largimin e një drejtuese të njohur të misionit të ODIHR-it, siç është znj. Glover.

Është për të ardhur keq, që kjo ndodh në një kohë kur angazhimi kryesor i qeverisë duhet të jetë pajisja me karta identiteti të të gjithë zgjedhësve që nuk kanë pasaportë, kur nga zgjedhjet e 28 qershorit na ndajnë vetëm 46 ditë.

KSHH e shikon të nevojshme t'i drejtohet qeverisë shqiptare dhe në mënyrë të veçantë, z. Kryeministër që të rishikojë qëndrimin e vet lidhur me kërkesën e mësipërme. Reflektimi



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mendojmë se i shërben interesave dhe imazhit të vendit tonë aq më tepër tani që jemi antarë të NATOS dhe synojmë integrimin në BE.

Lidhur me këtë çështje, KShH, i sugjeron gjithashtu z.Ristani, kryetar i KQZ-së, që të jetë më i rezervuar dhe më i matur në prononcimet publike të tija dhe të mos vihet në rolin e “arbitrit” ose të një “ndërmjetësi ekuilibruës”. Besimi i palëve (subjekteve zgjedhore) në procesin zgjedhor e garantojnë dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor.

3. THIRRJE E KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT (KSHH) DREJTUAR PARTIVE POLITIKE

Tiranë, më 25 Maj 2009

Më 28 maj 2009, sipas Kodit Zgjedhor, fillon fushata për zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009. Në fakt, partitë politike kanë disa muaj që e kanë filluar këtë fushatë, edhe pa qenë të regjistruara nga KQZ-ja si subjekte zgjedhore.

KShH si një organizatë joqeveritare me përvojë në fushën e monitorimit të zgjedhjeve, ka ndjekur me vëmendje takimet e here pas hershme të përfaqësuesve të partive politike me shtresat e ndryshme të elektoratit, përfshirë këtu konferencat e shtypit dhe debatet televizive.

Është e kuptueshme për të gjithë se, fushata zgjedhore nuk mund të zhvillohet pa debate. Prandaj, nuk mund të përjashtohen gjatë fushatës, rastet e retorikave pasionante, madje edhe të ndonjë teprimi. Por, sipas mendimit tonë, **kryesorja është aftësia për të shpalosur me argumenta bindëse, alternativat dhe programet e subjekteve përkatëse zgjedhore dhe jo akuzat e ndërsjella të shoqëruara me fyerje dhe shpifje deri edhe në cënimin e të drejtës së privatësisë.**

KShH me keqardhje konstaton se edhe në fushatën për zgjedhjet e këtij viti në disa raste etika zgjedhore është zëvendësuar me gjuhën e cinizmit e të urrejtjes.

Është pikërisht kjo, arsyeja që **KShH i bën thirrje subjekteve zgjedhore**, në radhë të parë partive më të mëdha të mazhorancës qeverisëse dhe të opozitës, **të shmangin çdo qëndrim apo veprim që do të acaronte atmosferën e fushatës dhe nuk do të shërbente zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të pakontestuar.**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH e shikon të nevojshme të theksojë se propaganda zgjedhore e ngarkuar me elementë që synojnë denigrimin e kundërshtarit politik dhe që personalizohet duke cënuar dinjitetin e njeriut, nuk ka asgjë të përbashkët me debatin konstruktiv dhe normat e kulturës demokratike.

Në këtë vështrim, **KShH sugjeron që vetë partitë politike (subjektet zgjedhore), nëpërmjet një akt-marrëveshjeje, ose kodi paraprak zgjedhor, të shprehin publikisht angazhimin dhe gatishmërinë e tyre se do të zhvillojnë një fushatë të ligjshme, të kulturuar, pa konflikte dhe pa eksese të tilla, që mund të tensiononin situatën në prag të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009.**

Po të shihet e arsyeshme, **një nismë e tillë mund të ndërmerrej edhe nga Presidenti i Republikës që përfaqëson unitetin e popullit dhe që në raste të veçanta, ndërhyrja dhe kontributi i tij, do të ishin mjaft të nevojshëm dhe të dobishëm.**

4. ASNJË ZGJEDHËS JASHTË LISTE

Tiranë, më 1 qershor 2009

Të nderuar Qytetarë!

Sipas Kodit Zgjedhor, Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të), jo më vonë se data 3 qershor 2009, në një vend publik dhe me hyrje të lirë, duhet të shpallin listat përfundimtare të zgjedhësve.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit u bën thirrje të gjithë zgjedhësve (edhe atyre që janë njohur më parë me listat paraprake të zgjedhësve) që të shkojnë dhe të njihen me listat përfundimtare.

Kjo është mundësia e fundit për të qenë të sigurt se emri juaj figuron në listë, dhe ditën e votimit ju mund të ushtroni lirisht të drejtën kushtetuese për të zgjedhur.

Nëse ju do të konstatooni se emri juaj nuk figuron në listën përfundimtare, keni të drejtë që deri një ditë para datës së votimit, t'i drejtoheni gjykatës me anë të një kërkesë. Kësaj kërkesë duhet t'i bashkëngjisni një dokument nga zyra e gjendjes civile se ju jeni banor i njësisë përkatëse të qeverisjes vendore dhe një vërtetim nga KZAZ-ja se ju, nuk figuroni në listën përfundimtare të



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

qendrës suaj të votimit. Me vendimin që do të marrë gjykata në favorin tuaj, nuk do të keni asnjë pengesë që të ushtroni të drejtën e votës.

Zgjedhjet e 28 qershorit 2009 janë të një rëndësie të veçantë. Pjesëmarrja sa më e gjerë në këto zgjedhje do të tregojë pjekurinë dhe vendosmërinë e popullit tonë për një të ardhme më të mirë drejt integritimit në Bashkimin Europian.

5. VONESA NË SHPALLJEN E LISTAVE PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHËSVE

Tiranë, më 8 Qershor 2009

Në bazë të nenit 54 të Kodit Zgjedhor, Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të), duhet të shpallin listat përfundimtare të zgjedhësve jo më vonë se data 3 qershor 2009 pranë çdo qendre votimi.

Për të konstatuar në vend zbatimin e dispozitës të mësipërme të Kodit Zgjedhor, **Komiteti Shqiptar i Helsinkit në datat 4 – 6 Qershor 2009, monitoroi shpalljen e listave përfundimtare në 812 qendra votimi në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Fier dhe Korçë në nivel qarku.**

Gjatë këtij vëzhgimi rezultoi se deri më 6 qershor 2009, **në 371 qendra votimi nuk janë shpallur listat përfundimtare, sipas renditjes që vijon:** në **Tiranë**, në 155 qendra votimi që përfshihen në KZAZ-të nr. 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 53, 54; në **Durrës** në 86 qendra votimit që përfshihen në KZAZ-të 8, 9 dhe 10; në **Elbasan** në 90 qendra votimi që përfshihen në KZAZ-të 12, 13, 14, 16 dhe 17; në **Shkodër** në 35 qendra votimi që përfshihen në KZAZ-të Nr. 40, 41, 42; në **Vlorë** në 5 qendra votimi që përfshihen në KZAZ-të me nr. 61, 62, 63.

Nga vëzhgimi në 34 qendra votimi të qarkut Gjirokastrë, 57 qendra votimi të Korçës dhe 50 qendra votimi të Fierit, u konstatua se ishin shpallur listat përfundimtare të zgjedhësve.

Vlen të përmendet se, **në disa qendra votimi ku janë shpallur listat përfundimtare konstatohet se nuk është respektuar neni 54 i Kodit Zgjedhor i cili detyron që listat përfundimtare të zgjedhësve të shpallen “...në një vend publik me hyrje të lirë...”.**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ndërkohë, në disa qendra të tjera votimi rezultuan fletë të grisura nga listat e publikuara gjë që dëshmon se ato nuk janë vendosur në mjedise të mbrojtura. Te tilla u vunë re, sidomos në Durrës (Komunën e Rrashbullit), Tiranë (KZAZ-të 53 dhe 46) dhe Shkodër.

Një problem tjetër që u konstatua ishte vendosja e listave në lokale private ku kufizohej akses i zgjedhësve për t'u njohur me to. E njëjta gjë edhe në disa institucione arsimore (shkolla) ku orari i hapjes në to ishte i kufizuar, konkretisht; në Durrës (komuna e Rrashbullit, KZZ-ja Nr.8, Bashkia Manes, Bashkia Maminas, Bashkia Sukth), në disa KZAZ të Tiranës me nr. 49, 53, 46, si dhe në Shkodër (KZAZ-të 40, 41, 42).

Vëzhguesit e KSHH-së gjatë këtij misioni të monitorimit hasën vështirësi në identifikimin e lokaleve private të caktuara si qendra votimi (Tiranë dhe Durrës).

E shikojmë të nevojshme të përmendim gjithashtu se, vëzhguesit e KSHH-së nuk patën mundësi të kontaktonin me një numër të konsiderueshëm të KZAZ-ve, sepse ata nuk ndodheshin në ambientet ku kryejnë detyrën.

Gjatë bisedave me disa anëtare të KZAZ-ve, konstatoam se mos shpalljen në kohë të listave përfundimtare, ata e justifikonin me mosdërgimin e listave përkatëse nga njësitë e qeverisjes vendore.

KSHH i bën thirrje KZAZ-ve që të shpallin menjëherë listat përfundimtare të zgjedhëve pranë çdo qendre votimi.

KSHH i sugjeron KQZ-së që të kontrollojë zbatimin e nenit 54 pika 2 gërma "a" të Kodit Zgjedhor dhe të marrë masat përkatëse për të parandaluar vonesat e mëtejshme dhe për të eliminuar shkeljet e tjera.

KSHH i sugjeron gjithashtu KQZ-së që, në kuadrin e programeve të edukimit zgjedhor të shtetasve nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar, si dhe në forma të tjera, të informohen zgjedhësit mbi mundësitë që kanë për t'u njohur me listat e shpallura, si dhe me të drejtën e tyre për t'iu drejtuar Gjykatës nëse emrat e tyre mungojnë në këto lista.

6. JEMI TË VONUAR: EDHE 13 DITË NA NDAJNË NGA DITA E ZGJEDHJEVE



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 15 Qershor 2009

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i informuar se mjaft Komisione të Qendrave të Votimit nuk ishin ngritur, nëpërmjet vëzhguesve të tij **në datat 10 – 13 qershor kreu një vëzhgim të pjesshëm për të konstatuar në vend funksionimin e KZAZ-ve dhe ngritjen e KQV-ve.**

Monitorimi u shtri në Tiranë (KZAZ-të Nr. 49, 43, 48, 56, 46, 54, 51, 55, 47, 48, 52 dhe 50), **Vlorë** (KZAZ-të Nr. 63, 61), **Elbasan** (KZAZ-të Nr. 12, 13, 14), **Fier** (KZAZ Nr. 18), **Gjirokastrë** (KZAZ Nr. 25), **Durrës** (KZAZ Nr. 8, 9, 10), **Korçë** (KZAZ nr. 28), **Shkodër** (KZAZ Nr. 40, 41) dhe në **Kukës** (KZAZ Nr. 34), **gjithsej në 26 KZAZ.**

Sipas orareve të afishuara në ambientet e punës të KZAZ-ve, rezultoi se ato duhet të ishin të hapura prej orës 8:00 – 13:00 dhe 16:00 – 18:00. **Megjithëkëtë edhe pse në 11 KZAZ u shkua disa herë, dyert ishin të mbyllura** dhe nuk ishte vendosur asnjë informacion për shtyrjen e orarit të punës ose mosrespektimin e tij.

Vlen të përmendet se si pasojë e tërheqjes së disa anëtarëve të KZAZ-ve dhe mosplotësimit të tyre, funksionimi i KZAZ-ve nuk ishte i plotë. Në disa KZAZ si psh në KZAZ Nr. 61, të Vlorës si pasojë e mungesës së kuorumit përkatës nuk mund të merreshin vendime.

Përsa i përket trajnimeve të anëtarëve të KZAZ-ve rezultoi të ishte kryer vetëm faza e parë. KSHH i sugjeron KQZ-së që të shpejtojë trajnimin e fazës së dytë duke patur parasysh se së afërmi duhet të fillojë edhe trajnimi i anëtarëve të KQV-ve.

Problematike dhe shqetësuese është ngritja e KQV-ve (rreth 4700 KQV me 32900 anëtarë dhe 4700 sekretarë).

Gjatë vëzhgimit në KZAZ-të, rezultoi se deri në datën 13 qershor 2009, nga KZAZ-të Nr. 53,, 48, 52, 50 (Tiranë), KZAZ nr. 63, 61 (Vlorë), KZAZ-të Nr. 12, 13, 14 (Elbasan), në Komunën e Dropullit (Gjirokastrë), dhe KZAZ-ja nr. 8 (Durrës) nuk ishin emëruar anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve.

Shkaku kryesor ishte **mosdorëzimi i propozimeve nga partitë politike (subjektet zgjedhore) përkatëse.**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KSHH e sheh të nevojshme të theksojë se sipas nenit 36 të Kodit Zgjedhor, propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve duhet ti paraqiten KZAZ-ve jo më vonë se 45 ditë para datës së zgjedhjeve (d.mth jo më vonë se data 15 maj 2009), ndërsa emërimi i tyre nga KZAZ-të jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve (dmth jo më vonë se data 8 Qershor 2009).

KSHH mendon se kjo vonesë e theksuar do të ndikojë negativisht jo vetëm në verifikimet formale nga ana e KZAZ-ve të kritereve dhe kushteve që sipas neneve 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor duhet të përmbushin anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve, por edhe në trajtimin jo cilësor ose mostrajnimin e anëtarëve të KQV-ve duke patur parasysh numrin relativisht të madh të tyre.

Lidhur me çështjen e mësipërme, KSHH konstatoi se një pjesë e KZAZ-ve për anëtarët dhe sekretarët e emëruar të KQV-ve nuk dispononte vërtetime apo dokumenta që parashikojnë dispozitat e mësipërme të Kodit Zgjedhor.

U konstatuan gjithashtu edhe raste ku të dhënat e paraqitura nga partitë politike nuk ishin verifikuar si psh nëse ata kanë të paktën arsim të mesëm, janë me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse, nëse ndaj tyre është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme, etj.,

KSHH duke patur parasysh konstatimet e mësipërme si dhe faktin se nga zgjedhjet e 28 qershorit 2009 na ndajnë vetëm 13 ditë e shikon të nevojshme:

1. **T'u bëjë thirrje subjekteve përkatëse zgjedhore** që të paraqiten menjëherë në KZAZ-të propozimet e tyre për anëtarë të KQV-ve
2. **I bën thirrje të gjitha KZAZ-ve** që të mos emërojnë anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve pa zbatuar nenet e Kodit Zgjedhor ku bëhet fjalë për papajtueshmërinë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së si dhe kushtetepër emërimin e tyre
3. **I sugjeron KQZ-së** që në zbatim të kompetencave të tij (neni 21 pika 3 e Kodit zgjedhor) të ushtrojë kontroll mbi respektimin e orarit të punës nga KZAZ-të dhe zbatimin rigoroz të dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim KSHH e shikon të nevojshme të theksojë se vonesat e mëtejshme në ngritjen e KQV-ve mund të ndikojnë negativisht në përmbushjen e detyrave të tyre ligjore gjatë ditës së votimit.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

7. NJOFTIM PËR SHTYP

Tiranë, më 18 Qershor 2009

Komiteti Shqiptar i Helsinkit nëpërmjet medias elektronike është informuar se sot në datën 18 qershor 2009, ora 9:45, në vendin e quajtur Grizhe, ka shpërthyer makina me të cilën udhëtonte Aleks Keka, anëtar i Këshillit të Qarkut Shkodër dhe kryetar i Partisë Demokristiane të Malësisë së Madhe.

Si pasojë e këtij shpërthimi ai ka gjetur vdekjen. Nga deklaratat e zëdhënësit të Policisë së Shtetit bëhet fjalë se sipas evidencave të policisë së shtetit, Aleks Keka njihet si person me precedentë penale në trafikun e lëndëve narkotike, të mjeteve motorike dhe të shpërthimeve me eksploziv me telekomandë.

KSHH mendon se deklaratat e tilla sidomos në kushtet kur çështja sapo ka filluar nuk janë të lejueshme, madje ato përmbajnë elementë të paragjykitimit. Vlen të përmendet se sipas deklaratave të drejtuesve të Partisë Demokristiane para ngjarjes, Aleks Kekës i janë bërë kërcënime. Nuk ka dyshim se kjo e dhënë do të jetë gjithashtu objekt i hetimit.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit nuk paragjykon rrethanat dhe shkaqet e kësaj ngjarjeje, por qoftë dhe për faktin se ajo ndodhi 10 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe se viktima ishte kryetar i PDK i Malësisë së Madhe, **një hetim i shpejtë, i plotë, objektiv dhe i gjithanshëm do të ishte i domosdoshëm.**

KSHH duke patur parasysh disa incidente që kanë ndodhur para dhe pas fushatës zgjedhore, ka bërë thirrje për të mënjeluar gjuhën e urrejtjes, fyerjet dhe shpifjet si dhe akuzat që çenojnë të drejtën e privacisë.

Eksese të tilla në mënyrë direkte ose indirekte e acarojnë atmosferën politike. Ato mund të nxitin dhe inkurajojnë kryerjen e veprave penale.

KSHH i sugjeron organeve të policisë së shtetit që veçanërisht në këto pak ditë që na ndajnë nga zgjedhjet e 28 qershorit 2009, të rrisin forcën e tyre zbuluese dhe parandaluese, të sigurojnë rendin dhe jetën e njerëzve.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Për KSHH-në, paragjykimet dhe konkluzionet e nxituara dhe të parakohshme mund të shoqërohen me pasoja të dëmshme.

8. 6 DITE PARA ZGJEDHJEVE

Tiranë, më 22 Qershor 2009

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në prag të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009, e sheh të nevojshme t'i drejtohet partive politike dhe vetë zgjedhësve në mënyrë që së bashku të arrijmë qëllimin kryesor – **zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.**

Në këtë vështrim, vullneti politik dhe zbatimi rigoroz i ligjit janë faktorë të rëndësishëm që në këto zgjedhje parlamentare të zhvillohen me standardet që kërkohen për zgjedhje të lira e të drejta.

Në këtë kuadër, vetëm 6 ditë përpara zgjedhjeve, KSHH e sheh të nevojshme të ritheksojë edhe njëherë thirrjen për zhvillimin e një fushate të qetë, duke shmangur gjuhën e urrejtjes, gjë që do të ndikonte pozitivisht edhe në atmosferën e ditës së votimit. Është koha të bëjmë kujdes më shumë, që të mos lejojmë në asnjë mënyrë, eksese të atilla, si ato që shpunë në humbjen e jetës së militantit të Partisë Demokratike në Qerret të Kavajës, apo eksese që shpunë në thyerjen e qendrave të votimit, presioneve ndaj kandidatëve për deputetë, etj.. Zgjedhësit janë të qartë sot, se qëllimi ynë kryesor mbetet përmbushja e standardeve.

KSHH shpreh shqetësimin se mjaft KQV ende nuk janë emëruar. Kjo ndodh se partitë politike përkatëse nuk i kanë paraqitur KZAZ-ve propozimet. Si rrjedhim është shkelur neni 36 i Kodit Zgjedhor që kërkon emërimin e të gjitha KQV-ve jo më vonë se data 8 qershor 2009. Për KSHH-në kjo vonesë vë në dyshim trajnimin cilësor të anëtarëve të KQV-ve.

Shqetësim tjetër është ai i disa ndryshimeve, bashkimeve apo ndarjeve pa kriter dhe jashtë afateve ligjore të qendrave të votimit. Veprime të tilla mund të sjellin konfuzion, sorrollatje dhe pakënaqësi të zgjedhësve. KSHH i sugjeron KQZ-së që në interes të ecurisë të procesit të rregullt zgjedhor të ndërhyjë për të parandaluar pasojat e dëmshme pavarësisht se ligji me këtë detyrë ka ngarkuar njësitë e qeverisjes vendore.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Veç kësaj, brenda datës 24 qershor 2009, në zbatim të nenit 95 të Kodit zgjedhor, partitë politike duhet ti paraqesin KZAZ-ve propozimet për anëtarët e grupeve të numërimit të votave. Çdo vonesë në këtë drejtim do të vinte në pikëpyetje jo vetëm ngritjen e grupeve të numërimit dy ditë para ditës së votimit, por dhe për trajnimin e tyre.

KZAZ-të, KQV-të dhe Grupet e numërimit të votave luajnë një rol të rëndësishëm në aspektet e ndryshme të administrimit zgjedhor. **Është kjo arsyeja që KSHH i sugjeron partive përkatëse politike që, me përjashtim të rasteve të rralla dhe të domosdoshme, të mos kërkojnë zëvendesimin e anëtarëve të propozuar prej tyre.**

Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit, sipas nenit 77 të Kodit Zgjedhor, është periudha e heshtjes zgjedhore.

KSHH sugjeron që dispozita e mësipërme të respektohet nga të gjithë subjektet zgjedhore si dhe nga media.

KSHH, duke patur parasysh përvojën negative të zgjedhjeve të mëparshme e shikon të nevojshme të theksojë se partitë politike, kandidatët për deputetë apo persona të tjerë nuk duhet të ndërhyjnë në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore dhe të grupeve të numërimit. Në të kundërtën kjo mund të shkaktojë konflikte, zvarritje dhe ndërprerje në dëm të procesit zgjedhor.

Me këtë rast, KSHH i bën thirrje zgjedhësve që kanë aplikuar për karta identiteti por nuk i kanë tërhequr, të shkojnë sa më parë në qendrat përkatëse dhe të pajisen me to. Kjo do të mundësonte ushtrimin prej tyre të së drejtës për të votuar. Gjithashtu, KSHH kujton të gjithë qytetarët që nuk kanë emrat në listat përfundimtare, t'i drejtohen sa më parë gjykatës.

Në përfundim, KSHH i bën thirrje zgjedhësve për nevojën e një pjesëmarrjeje sa më të gjërë në votimet e 28 qershorit 2009.

Këto janë zgjedhje tepër të rëndësishme, janë provë pjekurie dhe ndërgjegjësimi për një të ardhme më të mirë, për një demokraci më të konsoliduar.

Arritja e standarteve në zgjedhjet e 28 qershorit kushtëzon integrimin më të shpejtë të vendit tonë në BE.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

9. THIRRJE E KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT

Tiranë, më 2 korrik 2009

Komiteti Shqiptar i Helsinkit përjetoi me shqetësim situatën paszgjedhore që u krijua dy ditët e fundit, për shkak të bllokimeve të procesit të numërimit të votave në disa zona, e veçanërisht në qarkun e Fierit.

Kjo situatë është e papajtueshme me të drejtën për të votuar dhe respektimin e vullnetit të popullit, përmbushja e të cilëve përbën standardet themelore për zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri.

Në këtë kuadër, subjektet zgjedhore duhet të shprehin qartë zellin e duhur për respektimin e këtyre standardeve, kurse organet zgjedhore kanë detyrë të zbatojnë ligjin dhe vetëm ligjin, me përgjegjësi të plotë. Veçanërisht, një rol i rëndësishëm i përket Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili duhet të realizojë të gjitha detyrat e tij për administrimin e këtij procesi deri në fund, me objektivitet dhe besueshmëri.

KSHH bën thirrje për përmbylljen e gjithë procesit me shpejtësinë, korrektësinë, dhe dinnjitetin që votuesi shqiptar meriton.

10. DEKLARIMI I NXITUAR I KQZ- së, NUK RESPEKTON VOTËN E ZGJEDHËSVE

4 korrik 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me njoftimin e datës 3 Korrik, përmes zëdhënësit të tij, bëri të njohur ndarjen e mandateve të deputetëve për çdo forcë politike, pavarësisht se procesi i numërimit të votave nuk ka mbaruar tërësisht. Për më tepër, ky deklaram u krye në të njëjtën kohë, kur në KQZ kishin mbërritur dhe po trajtoheshin disa kuti votimi të panumëruara nga KZAZ-të përkatëse. **Pavarësisht se deklarimi i mandateve ishte paraprak, i kryer pa përfundimin e numërimit të votave, si dhe pa u shuar ende përplasjet dhe tensionet politike midis garuesve në lidhje me këto kuti votimi, ai nuk i shërben mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KSHH vlerëson se ky veprim i KQZ-së është një hap i nxituar, që cënon besueshmërinë e tij si një organ i paanshëm, por njëkohësisht cënon edhe respektimin e votës së qytetarit.

KSHH ka vënë në dukje edhe në raste të tjera se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kryer disa sjellje që vënë në dyshim paanësinë e tij. Jo sa duhet, ky Komision ka treguar vullnetin e mirë për të qenë objektiv dhe profesional në trajtimin e problemeve. Kjo do të arrihej me diskutimin më të gjerë dhe përpjekjeve më të mëdha për gjetjen e konsensusit midis anëtarëve të tij.

KSHH i bën thirrje KQZ-së për maturi, pasi mendon se veprime të tilla mund të çenojnë standardet e përgjithshme të këtyre zgjedhjeve, si dhe mund të sjellin acarime dhe tensione të mëtejshme. Gjithashtu, KSHH, i bën thirrje të gjitha forcave politike që të shmangin konfrontimet dhe të tregojnë qetësi, duke respektuar votën popullore.